

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 21-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 27.5.2022**

**Anëtarë të pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:**  
Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës i kryetarit të Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr.Metodija Jançeski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional:** mr.Dragica Ljubevska, mr.Emilija Janevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Ivona Mufisheva, mr.Magdalena Davidovska Dovleva, mr.Arben Saiti, Maja Damevska, mr.Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë:/**

Z. Petrushevski hapi seancën e 21-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski shpjegoi se Rendi i Ditës i propozuar do të plotësohet me Propozim-procesverbalin nga vazhdimi i seancës së parë të 19-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, e mbajtur më 20.5.2022, si Pika 1 dhe prandaj të gjitha pikat do të zhvendosen një pike më poshtë.

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri ndryshimet si mëposhtë:

**RENDI I DITËS**

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancës së 19-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, e mbajtur më 20.5.2022.
2. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 20-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, e mbajtur më 20.5.2022.

3. Propozim-vendim për anulim të Kërkesës për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksit dixhital tokësor, të paraqitur nga SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip.

4. Propozim për ngritjen (inicimin) e procedurës kundërvajtëse ndaj SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) nga LSHMAAV.

5. Propozim për inicim të procedurës për kundërvajtje ndaj SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) nga LSHMAAV.

6. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj operatorit SHTPSH ANTENA AS KTV SHPKNJP Kërçovë, për shkelje të nenit 141 nga LSHMAAV.

7. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbime: Lejen për sigurinë e pajisjeve të rrjetit kompjuterik (Firewall).

8. Të ndryshme.

### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin nga vazhdimi i parë i seancës së 19-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, e mbajtur më 20.5.2022, me tekstin e propozuar.

### **Pika 2**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e seancës së 20-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, e mbajtur më 20.5.2022, me tekstin e propozuar.

### **Pika 3**

Z. Trajçevski e shpjegoi Propozim-vendimin për refuzimin e Kërkesës për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit digjital tokësor, të paraqitur nga SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip. Ai shpjegoi se Studimi për përcaktimin e arsytimit për shpalljen e tenderit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit dixhital tokësor është përgatitur dhe dorëzuar tek të gjithë anëtarët e Këshillit të premtën e kaluar. Kujtojmë se një studim i tillë është kryer edhe në dhjetor 2020, i cili ka treguar të njëjtat gjetje si aktualisht, sepse periudha kohore është shumë e shkurtër dhe situata ekonomike nuk është përmirësuar aspak, por për shkak të disa faktorëve si kriza energjetike, lufta në Ukrainë etj, është përkeqësuar edhe më shumë. Nga studimi u konkludua se në vitin 2020 mediat në Republikën e Maqedonisë humbën një pjesë të madhe të të ardhurave, ndërsa në vitin 2021 filluan t'i kthejnë, por fitimi operativ nuk është në nivelin që ishte para pandemisë. Sa i përket numrit të mediave, veçanërisht televizioneve dimë se si është situata në vendin tonë dhe si rezultat i situatës ekonomike konkluzioni përfundimtar i Studimit është se nuk ka arsye për shpallje të konkursi publik për dhënie të lejes për transmetim

televiziv të shërbimi programor me format mbizotërues të përgjithshëm informativ ose format të përgjithshëm me tre funksione mediatike (informative, edukative dhe argëtuese), në nivel shtetëror, nëpërmjet multipleksi dixhital tokësor, siç thuhet në Kërkesën e paraqitur nga TV 24 Vesti. Për këtë arsye, në pajtim me dispozitat ligjore nga LSHMAAV, sugjerohet që Këshilli të marrë Vendim me të cilin refuzohet kërkesa në fjalë.

Z. Petrushevski shpjegoi se vetë Studimi është paraqitur tek të gjithë anëtarët e Këshillit para më shumë se një jave në formë elektronike dhe të gjithë kanë mundur ta lexojnë duke e shpallur dhe publikisht në ueb faqen e Agjencisë. Ai ka treguar se pozita e shërbimit profesional është në materiale, sqarim është dhënë nga drejtori i Agjencisë si propozues së bashku me shërbimin profesional për propozim-vendimin. Detyra e Këshillit është ta votojë apo jo dhe në këtë drejtim ka deklaruar se do të votojë pozitivisht propozimin e paraqitur në Këshill. Ai ka shpjeguar se nuk sheh asnjë mundësi tjetër ligjore përveç refuzimit të kërkesës nga TV 24 Vesti.

Z. Ajdini tha se Studimi i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme dhe relevante si analizën ekonomike, analizën e ofertës ekzistuese mediatike dhe analizën e nevojave të audiencës. Në analizën e ofertës programore ekzistuese është evidente nevoja për një format të specializuar programor, veçanërisht për filmat, sportet dhe programet dokumentare. Fatkeqësisht tha ai, nuk ka kërkesa të tillë dhe duhet pasur parasysh se me rritjen e numrit të televizioneve nuk gjeneron apo garanton automatikisht pluralizëm mediatik. Duke u mbështetur në këto konstatime, ai llogarit (beson) se Kërkesa duhet të refuzohet dhe deklaroi se po ashtu dhe do të votojë.

Z. Fidanoski njoftoi se në diskutimin e tij do të japë disa nga qëndrimet dhe mendimet e tij lidhur me Studimin, të cilin e konsideron se është bërë në mënyrë korrekte dhe profesionale, ofron të dhëna dhe analiza për shumë çështje që prekin këtë temë, por nga të cilat mund që të jetë në gjendje të nxjerrë përfundime dhe gjetje të ndryshme nga ato të regjistruara brenda përmbajtjes së Studimit. Ai shpjegoi se do të nxjerrë konkluzionet dhe qëndrimet e tij duke u bazuar në shifrat, të dhënat dhe faktet që gjenden brenda tij dhe në bazë të tyre në fund do të përmbledhë mendimin e tij për këtë (pyetje) çështje. Në përmbledhje, si vazhdimësi e mbylli diskutimin z. Ajdini, duke thënë se rritja e numrit të televizioneve nuk garanton automatikisht pluralizëm mediatik dhe tha se duhet saktësuar se kjo nuk garanton pluralizëm mediatik cilësor. Sigurisht që do të ketë një numër më të madh, por një numër i madh nënkupton edhe një proces më të gjatë por jo cilësor. Për sa i përket treguesve ekonomikë, pajtohet me atë që u tha në hyrje si propozim për këtë pikë nga drejtori z. Trajçevski se kriza e vitit 2022 e shkaktuar nga lufta në Ukrainë dhe e plotësuar më parë nga pandemia ofron pasiguri serioze për lëvizjet makroekonomike siç qëndron në Studim. Ai tha se do të komentojë për numrat që janë vendosur në tabela të cilët janë të dukshëm dhe të lexueshëm. Për shembull, produkti i brendshëm bruto nominal për periudhën 2017-2021, nëse shikoni në fund të asaj periudhe, nënkupton një rritje prej 1.72 miliardë euro ose 854 euro për frymë. Në të njëjtën periudhë nga viti 2021 ka 55 mijë të punësuar më shumë në krahasim me vitin 2017, paga mesatare është rritur për 5800 denarë në vitin 2021 në krahasim me vitin 2017, dhe nëse krahasohet me pagën e fundit të publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës, ajo pagë mesatare është më shumë se 8000 denarë. Për sa i përket tregut televiziv, ai tha se pesha e televizioneve kombëtare (dixhitale) tokësore është rritur nga 75.7 në 81.3% të tregut total në vetëm 5 televizione kombëtare tokësore. Dikush mund ta interpretojë këtë si argumentin kryesor pse kërkohet një Studim i tillë, prandaj kërkohet hapja e një konkursi publik për dhënien e lejes për televizionin kombëtar tokësor dhe me sa dihet multipleksi lejon dhe ka hapësirë. Ai shpesh herë ka thënë për temat tjera kur është diskutuar, qëndrimi është thënë në mënyrë pezhorative,

se televizionet kombëtare tokësore janë thënë kushtimisht si liga e parë dhe pjesa tjetër thënë kushtimisht si liga e dytë, e tretë në paraqitjen e mediave maqedonase. Sa i përket tregut tokësor, të ardhurat nga viti 2017 deri në vitin 2021 me luhajtje dhe mospërputhje janë rritur me 2.7 milionë euro, pikërisht aq sa thuhet në Studimin më poshtë, ku është bërë një projektion përlllogaritës i kostove vjetore për një stacion të tillë televiziv tokësor TV dhe thënë siç qëndron brenda janë marrë parametrat minimalë të nevojshëm për të bërë projektionin. Ai personalisht beson nga përvoja, pasi ka punuar 13-14 vjet në dy stacione televizive që kanë leje të tillë, se ato kosto duhet të jenë më të larta për të paktën gjysmë milioni deri në një milion euro. Fitim neto për të gjitha televizionet ka dhe është pozitiv, ndonëse siç tha z. Trajçevski fitimi operativ është i reduktuar, por përsëri ekziston. Dhe siç thuhet në Studim, sipas vlerësimit të përqendrimit konstatohet se hyrja e një lojtari të ri do të rrisë konkurrencën në hapësirën mediatike maqedonase. Është fakt që edhe buxhetet e reklamave janë në stanjacion, por nuk duhet harruar gjithashtu se në të kaluarën para të mëdha publike shkonin për reklamimin e politikave qeveritare apo shtetërore, megjithëse edhe tani shuma e tyre nuk është e papërfillshme, përkundrazi me paratë e zgjedhjeve për reklama politike zgjedhore mund të thuhet se është serioze. Sa i përket financimit, siç ka përmendur më herët është bërë një projektion prej 153 milionë denarë ose rreth 2,5 milionë euro si mjete minimale të nevojshme për funksionimin e një transmetuesi të tillë dhe siç ka përmendur më herët, mendon se shuma duhet të jetë më e lartë për rreth 1 milion euro. Studimi gjeti shumë stacione tokësore kombëtare, që do të thotë nëse shkojmë sipas analogjisë së këtij Studimi, mund të thuhet se këto 5 televizione kombëtare tokësore janë shumë, kështu që mund të konkludohet se prandaj këtu ka një përplasje të dy koncepteve sipas tij, e para është reduktim i stacioneve televizive në maksimum 3 siç është paraparë në treguesit e këtij dhe Studimeve të tjera që janë porositur dhe bërë më pare, pra kaq mund të përballojë tregu, dhe ai deklaroi se personalisht është kundër këtij koncepti. Koncepti i dytë është një rritje e numrit aq sa lejon multipleksi tokësor dixhital, ai mendon se ka hapësirë dhe për dy stacione të tilla televizive dhe personalisht është "për" këtë koncept të dytë. Ai tha nga përvoja se televizioni është një lodër e shtrenjtë, kushdo që i hyn këtij biznesi është i vetëdijshëm që duhet të bëjë një investim fillestar prej të paktën 2.3 dhe madje 4 milionë euro dhe të llogarisë në faktin që në 5 vitet e para një investim i tillë me siguri nuk do të kthehet, aq më tepër që mund të jetë në humbje nga puna e tij. Por ndikimi dhe imazhi në një shoqëri gjithashtu duhet theksuar për rëndësinë që ka. Ai theksoi se këto janë vetëm një pjesë e qëndrimeve të tij të shprehura për këtë çështje, ai e mban të drejtën që të diskutojë më tej për këtë temë nëse është nevoja dhe deklaroi se nuk do ta mbështesë propozimin për refuzimin e kërkesës së TV 24 Vesti.

Z. Petrushevski thekson se deri më tani nga qëndrimet e shprehura janë dy anëtarë të Këshillit që do të votojnë për refuzimin e kërkesës së 24 Vesti dhe një anëtar i Këshillit që nuk do ta mbështesë propozimin pra refuzim të kërkesës. Ai edhe një herë theksoi se mban qëndrimin që ka pasur dhe i respekton argumentet e dhëna në diskutimin e z. Fidanoski. Ka dy mundësi për t'u pranuar një kërkesë e tillë. Mundësia e parë është përmirësimi i situatës financiare në vend dhe është e dukshme që nuk është e mundur sepse po vjen duke u përkeqësuar, dhe mundësia e dytë është që ajo që thotë Studimi është Kërkesa për një format të specializuar. Asnjë nga ato kushte nuk është plotësuar dhe prandaj ai mbetet i mendimit se do të mbështesë propozimin e shërbimit profesional, drejtorit dhe Studimin për refuzimin e Kërkesës.

Z. Fidanoski tha se pajtohet se prioritet apo domosdoshmëri më e madhe për audiencën është hapja e kanaleve të specializuara televizive, filmike, sportive, dokumentare etj., sepse duket qartë

se mungojnë, por sipas tij duhet të krijohen parakushtet si pike e parë që një gjë e tillë të realizohet. Ai mendon se nevojiten ndryshime më të thella ligjore që do të mundësojnë një koeficient të ndryshëm në llogaritjen e tarifës vjetore sepse për disa kanale të specializuara leja e punës është edhe më e shtrenjta. Nëse bëni një analizë të vogël sipërfaqësore se sa paguhen në vit televizionet në rajon, do të vini re se lejet tona, sidomos për kanale të tilla, janë mjaft të larta dhe prej këtu shihet si arsye pse deri më tani nuk ka pasur të tilla kanale të specializuara, të cilat janë një nevojë e domosdoshme sipas opinionit dhe audiences dhe kjo është parësore dhe që vazhdimisht përsëritet dhe në disa hulumtime të mëparshme.

Z. Trajçev tha se pajtohet pjesërisht me diskutimin e z.Fidanoski dhe se është mirë që të ketë një ofertë më të madhe dhe të gjitha ato aspekte që i ka kapur janë një analizë e mire. Por ai tha se nga pikëpamja e Ligjit ka një kufizim të vogël në nenin 70 paragrafi (7), ku thuhet se nëse nga Studimi konstatohet se nuk ka arsyetim për shpalljen e konkursit publik, Agjencia brenda 8 ditëve nga ditën e publikimit të Studimit do të marrë Vendim me të cilin refuzon kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni. Ai shpjegoi se kjo e kufizon Këshillin që t'i përmbahet Studimit dhe në pajtueshmëri me ligjin duhet të pranojë atë që është dhënë si analizë në Studim. Pavarësisht nga qëndrimet e tij, të cilat pjesërisht janë të ngjashme me z. Fidanoski, ai do të mbështes propozimin për refuzimin e Kërkesës duke i'u përmbajtur Ligjit dhe Këshilli të veprjë në atë mënyrë.

Këshilli i Agjencisë me 5 vota "për" dhe një abstenim nga z. Fidanoski, miratoi Vendim me të cilin refuzon Kërkesën me shkrim nga pala e interesuar Shoqëria Tregtare Transmetuese 24 VESTI SHPKNJP Shtip nr. 03-24/1 datë 13.1.2022. (i yni PA nr. 08-13, datë 20.1.2022), për shpalljen e një tenderi (konkursi) publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv të shërbimit programor me format të përgjithshëm kryesisht informativ ose me format të përgjithshëm me tre funksione mediatike (informative, edukative dhe argëtuese), në nivel shtetëror, nëpërmjet multipleksi tokësor dixhital, për arsye se me Studimin për përcaktimin e arsyetimit për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit dixhital tokësor (Nr.ynë.ark.03-2051/3 datë 20.5.2022.) u konstatua se nuk ka arsyetim për shpallje të konkursit për shërbime programore televizive me: 1. format të përgjithshëm kryesisht argëtues, 2. format të përgjithshëm kryesisht informativ dhe 3. format të përgjithshëm në të cilin llojet e programeve të përfaqësuara përmbushin tre funksione mediatike, në nivel shtetëror, nëpërmjet multipleksit dixhital tokësor.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet të publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Z. Petrushevski pas votimit tha se dëshiron që në 2-3 vitet e ardhshme të kemi përmirësim të dukshëm të situatës financiare, të kalojnë të gjitha këto kriza të shkaktuara nga pandemia dhe nga lufta aktuale dhe se përbërja e ardhshme e Këshillit të ASHMA-së do të miraton Vendim për të formuar një tjetër televizion preferohet të jetë i formateve që janë shkruar në Studio.

#### **Pika 4 dhe 5**

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore, mr.Emilija Janevska arsyetoi propozimin për fillimin e procedurës kundërvejtëse ndaj SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) nga LSHMAAV për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) nga LSHMAAV. Ajo shpjegoi se do të bënte një hyrje për dy shkeljet sepse bëhet fjalë për të

njëjtin televizion. Dy shkeljet janë konstatuar nga mbikëqyrja e kontrollit të këtij viti në muajin maj. Këto dy shkelje për transmetues kanë një shtrirje që vitin e kaluar që nga mbikëqyrjet e rregullta që ishin kryer në nëntor të 2021. Atëherë transmetuesit bazuar në këto dy shkaqe për mostransmetim të së paku 30% të veprave audiovizive maqedonase, neni 92 paragrafët (1) dhe (3) dhe gjysma e këtyre veprave në periudhën prej orës 7 deri në 19 dhe shkak i dytë është neni 51 paragrafi (1) për mosdhënien e informacionit që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve të dhënat mbi emrin e plotë të ofruesit të shërbimit mediatik audiovizuel, adresa e zyrës qendrore të ofruesit të shërbimit mediatik audiovizual, të dhënat e kontaktit (numri i telefonit, adresa e postës elektronike dhe/ose faqen e internetit, personin përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe për organin rregullator kompetent, të cilin e kanë të obliguar ta shpallin të paktën një herë gjatë ditës në telop tek televizionet, i janë bërë dy paralajmërime publike, mbikëqyrjet e kontrollit kanë qenë në shkurt të vitit 2022 dhe përsëri është konstatuar shkelje e këtyre dy bazave. Por meqenëse mbikëqyrja e kontrollit u transferua në vitin e ardhshëm, përsëri iu shqiptuan masa paralajmërim publik duke i'u dhënë sërish afat për ta përmbytur. Praktikisht këto janë raportet e treta me këto dy baza ndaj TV GURRA, në të cilat konstatohen sërish shkeljet. Bazuar në kuotën për vepra audiovizuale maqedonase në nëntor të vitit 2021, kur është bërë mbikëqyrja fillestare transmetuesi nuk ka transmetuar fare vepra audiovizuale maqedonase. Nga mbikëqyrja në shkurt të vitit 2022, ka pasur rreth 4% vepra audiovizive maqedonase, dhe nga mbikëqyrja e tretë u rezultuar se sërish nuk ka fare vepra audiovizuale maqedonase. Prandaj në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, propozohet që të fillohet procedura kundërvajtëse për të dyja arsyet, me faktin se nëse Këshilli vendos të iniciojë procedurë kundërvajtëse për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) procedura për kundërvajtje do t'i referohet vetëm paragrafit (1) sepse nuk ka dispozitë penale në LSHMAAV për paragrafin (3).

Z. Petrushevski konstatoi se është bërë një hyrje e përbashkët për Pikat 4 dhe 5 dhe sugjeroi që nëse ka diskutim, të jetë për të dyja pikat dhe votimi të jetë individual për secilën pikë veç e veç.

Z. Ajdini tha në fillim se do të votonte "pro" për të dyja pikat, pra do të pranonte propozimet nga shërbimi profesional. Ai shpjegoi se Këshilli për herë të parë jep vërejtje publike për shkelje të konstatuar. Shihet se sidomos transmetuesit vendorë pas mbikëqyrjes kontrolluese nuk veprojnë sipas masës së shqiptuar për vërejtje publike dhe vazhdojnë të shkelin dispozitat e Ligjit. Ai nuk beson se transmetuesit qëllimisht vazhdojnë të shkelin ligjin, ai është i sigurt se janë të informuar siç duhet. Duhet të merret parasysh kriza ekonomike dhe gjobat që janë të rënda, si dhe ajo që ka theksuar drejtori para seancës për një televizion nga Gjevgjelia, ku shihen dhe mangësi të tjera me mbikëqyrjen e kontrollit dhe marrin nga dy-tre paralajmërime. Këshilli trajton të gjithë transmetuesit në të njëjtën mënyrë, duke kujtuar se një transmetues të cilit i është hequr leja ka akuzuar në një seancë se me qëllim është akuzuar për kundërvajtje. Duke u nisur nga kjo, ai mendon se nuk do të ishte keq të organizohej një takim pune me transmetuesit vendas që vite më parë, sidomos në këtë periudhë ku një transmetues bën dy shkelje dhe duhet të shqiptohen dy masa kundërvajtje, të cilat sigurisht që do të ndikojnë në punën e tyre. Ai theksoi edhe një herë se nuk do të ishte keq të organizohej një takim pune me transmetuesit, ku Sektori i Çështjeve Programore e di se cilët janë ata transmetues të grupin më të rrezikuar. Ai gjithashtu do të merrte pjesë në atë takim ose do të gjente një mënyrë për t'i kontaktuar më shpesh këta transmetues, sepse ata nuk duhet vetëm të shpresojnë se organi kompetent do t'u japë një vërejtje ose do t'i

ndëshkojë minimalisht. Ai e di që duhet respektuar Ligji dhe se nuk duhet të jenë selektivë por duhet të kenë trajtim të njëjtë me të gjithë transmetuesit, por sidomos kur bëhet fjalë për transmetuesit vendor, këto vendime sigurisht që do të ndikojnë në punën e tyre të mëtutjeshme.

Z. Petrushevski tha se sipas ligjit do t'i përkrah dy propozimet për fillimin e procedurës për kundërvajtje. Ajo që ai dëshiron të theksojë është diskutuar edhe më parë, se realisht për mediat e vogla këto masa janë disproporcionale në Ligj. Gjykata gjobit një media që ka të ardhura në miliona euro dhe një media që ka të ardhura nën 100 mijë euro, ligji parashikonte të njëjtat gjoba për të gjithë. Ai tha se shërbimi duhet të ketë parasysh ndryshimet e radhës në LSHMAAV me propozime që të bëhet më e drejtë sipas përqindjes së të hyrave ose të ngjajshme në mënyrë që dënimet të jenë të ndryshme për grupe të ndryshme transmetuesish. Nuk është e mundur që televizioni në nivel shtetëror dhe një media lokale që mezi po mbijeton të ketë të njëjtin dënim për procedurë kundërvajtëse siç parashikohet aktualisht në Ligj. Ai përsëriti se do t'i mbështesë të dyja masat sepse në bazë të Ligjit nuk ka zgjidhje tjetër.

Z. Fidanoski tha se bashkohet dhe i përkrah të dy propozimet por i bashkohet edhe propozimit të z. Ajdini për organizimin e takimit të punës me transmetuesit lokal dhe rajonal. Ai e di që shërbimi profesional e ka bërë këtë disa herë deri më tani, se është shpjeguar në detaje, por është përgjegjësi e Agjencisë dhe e Këshillit që të mundësojnë dhe përmirësojnë ambientin për të gjithë transmetuesit aq sa munden. Shpjegimi i Agjencisë do të kontribuojë në përmirësimin e atij mjedisi, të paktën që transmetuesit ta kuptojnë plotësisht, 100%, ai nuk ka ndërmend të ofendojë askënd me këtë mendim të tij se çfarë duhet të bëjnë pasi të marrin paralajmërim publik dhe ku duhet të korrigojnë, sigurisht që ai flet për ata që kanë bërë një shkelje nga pakujdesia sepse shpesh ndodh. Ata që me vetëdije shkojnë në procedurë kundërvajtëse, nuk mund të thotë për askënd, por thotë hipotetiki, kjo është pyetje tjetër. Nëse takimet duhet të përsëriten çdo vit në përputhje me detyrimet e Shërbimit Profesional, nuk do të ishte e tepërt.

Z. Ajdini tha se qëllimi i tij ishte të organizonte atë takim sepse disa transmetues i kanë kërkuar këto takime. Në atë takim ata duhet të pyeten drejtpërdrejt nëse ka qenë gabim i qëllimshëm, siç tha z. Fidanoski apo nëse ankohen se nuk i marrin letrat në kohë dhe mundohen të shpjegojnë një sërë gjërash të tjera, që sipas tij janë jo korrekte, por gabime ndodhin dhe Këshilli është a'i që vendos. Për këtë arsye, ai mendon se do të ishte e dobishme të organizohej një takim.

Z. Petrushevski tha se asnjë nga anëtarët e Këshillit që diskutuan dhe të tjerët që nuk diskutuan nuk janë kundër propozimit të z. Ajdini dhe ai e përkrah dhe pret që shërbimi profesional ta realizojë atë.

#### *votimi sipas pikës 4*

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kontrollit programor nr. 10-2071/1 të datës 20.5.2022 ndaj SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë dhe konstatoi shkelje të nenit 92 paragrafi (1) nga LSHMAAV.

Këshilli njëzëri konkludoi se ndaj SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë të inicojë procedurë kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente pasi nga mbikëqyrja u konstatuar se më 9.5.2022 transmetuesi në fjalë nuk ka transmetuar së paku 30% të programit të krijuar fillimisht si vepra audiovizive maqedonase që është në kundërshtim me nenin 92 paragrafi (1) nga LSHMAAV.

Sektorin për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik duhet të përgatisë Kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje pranë gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

#### votimi sipas pikës 5

Këshilli i Agjencisë ka shqyrtuar raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kontrollit administrativ nr. 10-2078/1 të datës 20.5.2022 ndaj SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë dhe ka konstatuar shkelje të nenit 51 paragrafit (1) nga LSHMAAV.

Këshilli njëzëri konkludoi se ndaj SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë që të inicojë procedurë kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente për shkak se nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi në fjalë nuk ka ofruar informacion që duhet t'u vihet në dispozicion shfrytëzuesve më 9.5.2022, gjë që është në kundërshtim me neni 51 paragrafi (1) nga LSHMAAV.

Sektorin për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik duhet të përgatisë Kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje pranë gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

#### **Pika 6**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për dhënien e masës për vërejtje publike ndaj operatorit SHTPSH ANTENA AS KTV SHPKNJP Kërçovë, për shkelje të nenit 141 nga LSHMAAV. Ai ka shpjeguar se në këtë operator mbikëqyrja ka konstatuar se ai ritransmeton një shërbim programor "Russia Today Documentary" për të cilin Agjencia nuk ka lëshuar certifikatë. Për këtë urdhërohet që menjëherë të mbyllë kanalën dhe t'i shqiptojë masë vërejtje publike dhe më pas të kryejë mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse operatori ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi raportin me shkrim për mbikëqyrjen e rregullt të programit, nr.11-2054/1 datë 20.05.2022 dhe njëzëri konkludoi ndaj SHTPSH ANTENA AS KTV SHPKNJP Kërçovë që t'i shqiptojë masë vërejtjeje publike për shkelje të nenit 141 nga LSHMAAV dhe në pajtueshmëri me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimit të Agjencisë për shqiptim të masës nr. 01-6039/1 datë 20.10.2015, e urdhëron menjëherë pas marrjes së vendimit për paralajmërim publik të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja u konstatuar se SHTPSH ANTENA AS KTV SHPKNJP Kërçovë, e cila edhe pas njoftimit të Agjencisë për Komunikime Elektronike ka kryer aktivitet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 20.5.2022 ka ritransmetuar shërbimin programor "Russia. Today Documentary" për përdoruesit e tij, i cili nuk mbulohet nga certifikata e regjistrimit të shërbimeve programore të dhëna nga ASHMA-ja, e cila është në kundërshtim me nenin 141 nga LSHMAAV.

Sektorin për çështje juridike duhet të përgatisë vendimin për dhënien e vërejtjes publike operatorit të caktuar.

Sektorin për planifikim strategjik dhe të drejtën e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Vendim për paralajmërim publik duhet të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektorin për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet të publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.



## **Pika 7**

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik, Cvetanka Mitrevska sqaroi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbime: Lejen për pajisje të sigurisë së rrjetit kompjuterik (Firewall). Ajo shpjegoi se dhënia e lejes po bëhet me qëllim për furnizim publik që do të mundësojë siguri më të madhe të rrjetit kompjuterik dhe parandalimin e sulmeve të jashtme kibernetike. Kjo është e paraparë në Planin Vjetor për Furnizim Publik dhe mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2022. Sipas shumës së vlerësuar, ky furnizim do të kryhet siç parashihet në Ligjin për Furnizim Publik për furnizime me vlerë të ulët, ku si kriter për dhënien e kontratës është raporti më i mirë ndërmjet çmimit me 70 pikë dhe cilësisë 30 pikë. Të gjitha të dhënat e tjera në lidhje me blerjen gjenden në materialet e dorëzuara pas pikës.

Z. Petrushevski shtoi se vlera e parashikuar është diku rreth 200 mijë denarë për një vit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri i dha miratimin Drejtorit të Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbime: Lejen për pajisje të sigurisë së rrjetit kompjuterik (Firewall).

Zbatimi i procedurës së furnizimit publik për subjektin-shërbim: Leja për pajisje sigurie të rrjetit kompjuterik (Firewall) është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për Furnizimit Publik për vitin 2022 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (Tekst i zbardhur) nr.05-563/2 datë 8.2.2022 dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2022.

## **Pika 8**

### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Nr.02-2108/7**

**06.06.2022**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike**

**Audio dhe Audiovizuale**

**Kryetari i Këshillit**

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**